



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 15/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë dhe me zyrtaren e lart ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Milija Biševac, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politike Aktivna Gradjanska Inicijativa-(AGI), në Zubin Potok, paraqitur kundër vendimit me nr 533/2017 të dt. 23.05.2017 të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 29.05.2017, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si i pas afatshëm apeli i Milija Biševac nga Subjektit Politik Aktivna Gradjanska Inicijativa (AGI)

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 26.05.2017 ka pranuar një apel, nga Milija Biševac, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politike Aktivna Gradjanska Inicijativa, në Zubin Potok i cili kishte qenë në koalicionin subjektin politik “Partija Kosovskih Srba”.

Parashtuesi i ankesë thekson se është larguar nga lista e kandidatëve për deputet kundër vullnetit të tij dhe pa asnjë informim. Vendimin për tërheqjen tij nga lista e kandidatëve e kishte parashtruar kryetari i subjektit politik “Aktivna Gradjanska Inicijativa” -AGI, por sipas tij pa u konsultuar paraprakisht me të, dhe pa i dhënë asnjë arsyetim për tërheqjen e kandidaturës për deputet në Kuvendin e Kosovës.

Me këtë rast parashtuesi kërkon që kandidatura e tij të shpallet serish e vlefshme, dhe që PZAP-i ti mundësojë që në mënyre legale dhe legjitime të merr pjesë në zgjedhjet si kandidat për deputet në Kuvendin e Kosovës.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoj KQZ-në me datën 26.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet në afatin deri më 27.05.2017.

PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja brenda afatit të caktuar me të cilën theksohet se kryetari i partisë politike "Aktivna Gradjanska Inicijativa" AGI, ka dorëzuar në Zyrën e regjistrimit të partive politike më datë 23.05.2017, një kërkesë për tërheqjen e kandidatëve nga lista e koalicionit "Partija Kosovskih Serba-Aktivna Gragjanska Inicijativa" me nr të protokollit 533/23.05.2017. Zyra menjëherë e ka njoftuar kryetarin e partisë PKS, Aleksandar Jablanovic, si pjesë e koalicionit i cili kishte dorëzuar në listë me ndryshime, në kopje të fortë të nënshkruar dhe në CD.

Me datë 23.05.2017, KQZ ka certifikuar subjektin politik të lartëcekur ndërsa me datë 24.05.2017 i ka certifikuar kandidatët e po të njejtit subjekti politik.

Zyra konsideron se Ankesa Anr.15/2017 është e pabazuar për arsye se ka kaluar afati për korrigjim, përmirësim në listat e kandidatëve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmëri e apelit gjeti se :

Apeli është i pasafatshëm .

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se apeli i parashtruar është jashtë afatit ligjor sepse afati ligjor në bazë të nenit 28.1 të LZP-së, ka qenë 2 ditë para hedhjes së shortit për zgjedhje dhe se Apeli është parashtruar në PZAP më datë 26.05.2017 në ora 16:05 ndërsa hedhja e shortit nga KQZ-ja për Zgjedhjet e Parakoshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, ka ndodhur po të njejtën ditë 26.05.2017 në ora 11:30

Andaj nga kjo del se apeli në fjalë është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor në LZP. Prandaj duke u bazuar në Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it nenin 11.5. dhe nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, apeli vlerësohet si i pasafatshëm, lidhur me apelin e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 15 /2014 më datën 29. 05.2017.

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi

Udhëzim Juridik: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesën në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (Njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP .

